

RENDI I DITËS

Shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr.48, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr. 300, datë 05.04.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj. ,**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 08.04.2023 në orën 11:45 zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr. 48, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr. 300, dt. 05.04.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për krytar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Largimin e kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Bashkisë Mallakastër, shtetasit Qrim Ismailaj, propozuar nga Partia Socialiste”. Procedura e shortit parashikohet në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në një ëshë shënuar kërkesa ankimore nr. 48, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Të gjithë shiritat pasi palosen do të futen në 5 gogla me peshë , ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.04.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Kërkesa ankimore nr. 48.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i Kërkesës Ankimore nr. 48, është caktuar zoti Ledio Braho. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

